



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1008/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me procesëmbajtësen Nexhmije Abazxhik, në konfliktin administrativ, të paditësit N.N.P. N. nga P. kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim tatimor, duke vepruar sipas aktgjykimit A.A.32/2016 datës 28.06.2016 i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 13.12.2016, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, e në mungesë të përfaqësueses ligjore të palës së paditur, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit N.N.P. N. nga P.

ANULOHET PJESËRISHT vendimi nr.253/2013 i datës 18.10.2013 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe periudha tatimore e vlerësimit 2009 dhe 2010 për faturat tatimore nga subjektët V. O. shpk –P., NTSF F. Com-P., NTP V. Com-P., kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Vlersimet tjera mbesin në fuqi sipas Njoftim Rivlerësimeve të tatimit shtesë të caktuara me Raportin e Kontrollit, dhe vendimit nr.253/2013 dt.18.10.2013 i Departamentit të Ankesave i ATK-së.

### A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë (ATK) ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit, ka ndryshuar pjesërisht Njoftim Rivlerësimit për TAP për periudhën 2009,2010 dhe 2011.

Paditësi N.N.P. N. nga P. me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 03.12.2013, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar aprovimin e padisë si të bazuar dhe anulimin e vendimit Departamentit të Ankesave të ATK-së, nr.253/13 dt.18.10.2013.

Në padinë e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi ka deklaruar se e paditura me kontrollin e kryer me datë 19.07.2013 për periudhën tatimore 2009-2013 ka bërë disa lëshime që kanë të bëjnë me mospranimin e faturave të cilat na janë lëshuar nga furnitorët me të cilët kemi bashkpunuar. Ky mospranim i faturave rezulton me obligim shtesë në vlera të mëdha financiare dhe në atë mënyrë na obligon për tatim shtesë. Faturat e lëshuara nga subjekti F. Com nga P. nuk na janë pranuar si të zbritshme për TVSH dhe TAP, e ato janë faturat nr.260410 dt.26.04.2010, 050510 dt.05.01.2010, 170510 dt.17.05.2010, 020610 dt.02.06.2010. Këto fatura nuk na janë pranuar si të zbritshme as në TAP as në TVSH me arsyetim se ka të bëjë me një biznes i cili për ATK është fiktiv dhe nuk i ka deklaruar të gjitha transaksionet që i ka bërë. Gjithashtu jemi të dëmtuar edhe për faturat e lëshuara nga subjekti V. Com, për faturat 0212/10 dt.03.12.2010, 1412/10 dt.15.12.2010, 0312/2012. Pastaj nuk na janë pranuar faturat nga subjekti V. Oil nga P. për faturat nr.016 dt.26.03.2009, 051

dt.22.12.2009. Ne si kompani kemi bashkëpunuar me këto biznese e me rëndësi është që transaksionet kanë ndodhur dhe ne kemi marrë materialin i cili është i cekur në fatura. NT F. Com është regjistruar me datë 18.01.2007, këtij biznesi i është marrë çertifikata e TVSH-se dhe është publikuar me datën 26.05.2010 e ky publikim ka dal në faqet zyrtare të ATK. Subjekti N.T.P. V. Vom është e regjistruar me 04.06.2010 kurse çertifikata e TVSH i është marrë dhe është publikuar në sajtin zyrtar të ATK me datën 03.10.2013. Pra këto publikime kanë ndodhur pas bashkëpunimit tonë me këta subjekt afarist dhe ne nuk kemi pas mundësi të parashikojm se çka do të ndodh me këto biznese mbas bashkëpunimit tonë me ta. Përfaqësuesi i autorizuar në seancë thekson se në ekspertizën financiare gjërat janë trajtuar drejtë sipas ligjit dhe duhet të panohen si tilla sepse gjitha faturat të cilat janë kontestuese janë të lëshuara dhe malli është dorëzuar në subjektin afarist NNP "N." dhe lloj llojshmëria e mallit furnizues përputhet me kërkesat sipas kontratave për kryerjen e shërbimeve në atë periudh. Mallin me këto fatura tatimore e kam marrë nga këta subjekt me kompenzim ashtu që unë ju kam kryer shërbime, aktivitete të ndryshme. Gjithashtu deklaroj se kontrolli i ATK-së ka qenë vetëm njëher në vizitë tek ne, që ka kërkuar dokumentacionet e firmës dhe nuk ka kërkuar asnjë informatë tjetër lidhur me këto fatura tatimore kontestuese.

E paditura përmes përfaqësueses ligjore në përgjigjen në padi datës 29.05.2014, ka deklaruar se, e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Në parashtrësë theksohet se pas verifikimit të regjistrimeve dhe analizave sipas periudhave dhe llojeve të tatimit, gjatë kontrollit janë konstatuar ndryshime të cilat kanë rezultuar me tatim shtesë sipas periudhave tatimore për të cilat është zhvilluar kontrolli. Mbi bazën e qarkullimit shtesë nga periudha 01/2009 deri me 12/2012 të cilin paditësi nuk e ka deklaruar korrekt i konstatuar me kontrollin në bazë të dëshmimeve, dokumentacionit të biznesit dhe informatave nga palët e treta të cilat janë verifikuar me rastin e kontrollit, është konstatuar edhe shmangie e tatimeve. Nga Departamenti i Ankesave janë korigjuar pjesërisht Njoftim Rivlerësimet sa i përket shpenzimeve të interesit, provizioneve bankare dhe shpenzimeve të amortizimit. Këto korigjime janë bërë sipas këtyre vlerave dhe periudhave të kontrollit: periudha 2009 në vlerën prej 22,846.25€, periudha 2010 në vlerën prej 18,019.71€ si dhe periudha 2011 në vlerën prej 38,724.60€ Këto korigjime kanë qenë të pjesërishtme në Njoftim Rivlerësimet. Sa i përket pikave tjera të konstatuara me kontrollin e kryer, Departamenti i Ankesave po ashtu ka konstatuar se është vlerësuar drejt dhe ka konfirmuar vlerësimin e kontrollit të datës 12.07.2013 bazuar në dokumentacionin biznesor të ofruar nga paditësi dhe legjislativin e aplikueshëm nga e paditura dhe si të tilla mbesin pa ndryshime. I propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave të bashkangjitura të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit, në tërësi si të pabazuar duke lënë në fuqi vendimin nr.253/13 dt.18.10.2013 të Departamentit të Ankesave i ATK-së.

Përfaqësuesja ligjore e të paditurës e pakënaqur me aktgjykimin A.nr.1585/2013 dt.21.10.2015 të kësaj gjykate, ka parashtruar ankesë me datë 16.12.2016 drejtuar Gjykatës së Apelit të Kosovës e cila me aktgjykimin A.A.nr.32/2016 datës 28.06.2016 aprovon ankesën, ka prishur aktgjykimin A.nr.1585/13 datës 21.10.2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje konform vërejtjeve të dhëna në arsyetimin e aktgjykimit të cilat konsistojnë në faktet se:

- gjatë shqyrtimit të çështjes nuk janë marrë parasysh pohimet e të paditurës, pse faturat janë konsideruar fiktive si dhe pse transaksioni nuk ka ndodhur fare me subjektët nga të cilët janë lëshuar faturat tatimore . Nuk ka prova se eksperti ka marr të dhënat nga e paditura lidhur me ekspertizën që do ta bëj, andaj konstatimi dhe mendimi i ekspertit është jo i plotë ngase nuk përmban të gjitha të dhënat lidhur me faktet që duhet ti paraqes dhe i njëjti nuk ka bërë sqarime plotësuese në bazë të vërejtjeve dhe kundërshtimeve të palës së paditur.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se përfaqësuesja ligjore e palës së paditur përmes parashtrësës dt.13.12.2016 ka njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantoj në seancë dhe ka propozuar që të veprohet sipas dispozitave të nenit 38 par. 5 të LKA-së, (provë: parashtrësja e datës 13.12.2016 nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit publik të datës; 13.12.2016, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e datës

29.05.2014 nga Ministria e Drejtësisë, vendimi nr. 253/13 dt. 18.10.2013 nga ATK, Raporti i kontrollit i datës 12.07.2013, fakturat tatimore nga subjektët V. Com, F. Com dhe V. Oil, libri i blerjes të paditësit për vitin 2010, ekspertiza financiare me dokumentacionin përcjellës, aktgjykimi A.A. nr.32/16 dt.28.06.2016 nga Gjykata e Apelit të Kosovës, plotësimi i ekspertizës dt.14.11.2016, kundërshtimi i ekspertizës financiare nga ATK-së dt.13.12.2016.

Gjykata pas pranimit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, analizimit të vërejtjeve, duke vlerësuar gjendjen faktike nga shkresat e lëndës, shkaqet e aktvendimit kontestues të goditur si dhe duke vlerësuar thëniet dhe pretendimet e paditësit, deklarimeve në përgjigjen në padi dt.29.05.2014, deklarimeve në seancat paraprahe dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 13.12.2016, provave të siguruara gjatë procedurës në konflikt administrativ, konstaton se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar, dhe gjykata ka vendos që ka kthej në rishqyrtim vetëm periudhën tatimore të vlerësimit 2009 dhe 2010 për faturat tatimore nga subjektët Visioni O. shpk –P., NTSH F. C.-P., NTP V. Com-P., ndërsa vlerësimet tjera mbesin në fuqi vendimit nr.253/2013 dt.18.10.2013 i Departamentit të Ankesave i ATK-së me të cilin është aprovuar pjesërisht ankesa e paditësit.

Lidhur me rekomandimet e Kolegjit të Apelit, se nuk ka prova se eksperti ka marr të dhënat nga e paditura lidhur me ekspertizën që do ta bëj, dhe nuk janë bërë sqarime plotësuese nga ana e ekspertit financiar në bazë të vërejtjeve dhe kundërshtimeve të palës së paditur, gjykata në procedurën e rivendosjes sqaron se eksperti financiar i caktuar në këtë konflikt administrativ, i është drejtuar me kërkesë për dokumentacion shtesë të paditurës Administratat Tatimore e Kosovës në Prishtinë, e cila kërkesë është e protokoluar me nr.06.06.2751 dt.07.09.2015, mirëpo e paditura nuk i ka dorëzuar ekspertit financiar asnjë dokument relevant që ka të bëj me këtë çështje konkrete, përderisa e njëjta në kundërshtimin e ekspertizës financiare të dhënë me datë 09.10.2015, e vë në dyshim se ka pranuar ndonjë kërkesë për dokumentacion dhe info shtesë. Pra gjykata ka konstatuar se ekzistojnë provat materiale se palës së paditur i është drejtuar eksperti financiar me kërkesë zyrtare të protokoluar nga vet e paditura, mirëpo nuk ka prova se e paditura ka dhënë ndonjë përgjigje apo ka ofruar ndonjë dokument shtesë lidhur me kërkesën e parashtruar nga eksperti financiar gjyqësor.

Megjithatë me qëllim që të respektohen rekomandimet e Kolegjit të Apelit, kjo gjykat në rivendosje ka kërkuar nga eksperti financiar që ta plotësoj ekspertizën financiare, dhe me datë 14.11.2016 Shaban Muharremi Ekspert financiar gjyqësor ia ka dorëzuar gjykatës sqarimin shtesë lidhur me ekspertizën e datës 29.09.2015, të cilën gjykata iu ka dërguar të dyja palëve ndërgjyqëse.

Gjykata ka pranuar vlerësimet e ekspertizës financiare se faturat blerëse kontestuese i takojnë periudhës para datës së hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 dt.19.11.2010 dhe disa prej tyre janë lëshuar para datës së anulimit të çertifikatës së TVSH-së nga e paditura dhe publikimit në evidencat e tatimpaguesve jo-aktiv. Në anën tjetër sipas Listës së Distribuimit dt.06.08.2010 e grupit punues të ATK-së është rekomanduar që transaksionet e kryera para datës 09 Shtator 2009 me bizneset e publikuara në web faqen zyrtare të ATK-së, do të njihen për qëllime tatimore si transaksione të rregullta, e që në rastin konkret ekziston fatura kontestuese e datës 26.03.2009 e lëshuar nga V. Oil. Paditësi ka deklaruar para gjykatës se mallin me këto fatura e ka marr me kompenzim duke ju kryer të njëjtëve subjekt shërbime, aktivitete të ndryshme. Nga faturat kontestuese blerëse, gjykata ka vërejt se kemi të bëjmë me material për ndërtimtari (cement, monta, blloka, aramaturë, rrjeta, zall, beomall, dritare, pvc, dyer pvc, pllaka qeramike, plokolor, gypa), dhe sipas dokumenteve që ka paraqit paditësi, malli sipas faturave kontestuese është përdor gjatë ushtrimit të aktivitetit të paditësit në dokumentin “Para masa dhe parallogaria-rekapitulimi” kontrata M-2 8400/008 me Mercy Corps për ndërtimin e 43 shtëpive, kurse harxhimi është përshkruar në ditarin e punës të datave të përafërta kur edhe është furnizuar me material.

Në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura Departamenti i Ankesave i ATK-së ka bërë vetëm arsyetimin e ndryshimeve të Njoftim Rivlerësimeve për TAP për periudhën 2009, 2010, dhe 2011, ndërsa sa i përket pozicioneve tjera tatimore të vlersuara me kontroll, Departamenti i Ankesave në mënyrë të përgjithshme thekson se kontrolli ka vepruar në përputhshmëri me dokumentacionin e ofruar dhe legjislacionin e aplikueshëm nga ATK-së. Përfaqësuesi i kontrollit gjatë seancës dëgjimore pranë

Departamentit të Ankesave të ATK-së, thekson se subjekti F. Com konsiderohet tatimpagues fiktiv. Nga Raporti i Kontrollit dt.12.07.2013 në vlersimin final, kontrolli ka ardhur në përfundim se faturat e blera nga subjektët F. dhe V. Com, nuk do të pranohen si blerje e as si KMSH, pasi që me këto dy subjekte paditësi ka marrë faturat e nuk ka ndodhur transaksioni.

Gjykata duke bërë një vlersim të tillë të gjendjes së verifikuar nga kontrolli, dhe duke marr për bazë rekomandimet e Gjykatës së Apelit, pse faturat blerëse janë konsideruar fiktive, gjykata konsideron se në këtë drejtim ekzistojnë mangësi në vërtetimin e drejt të gjendjes faktike, pasi që në shkresat e lëndës gjykata nuk posedon dëshmi se kontrolli ka ndërmarr veprimet adekuate në kuadër të autorizimeve ligjore nga neni 19 par.2 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, për të vërtetuar se vërtet bëhet fjalë për fatura fiktive. Nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetoj se si ka ardhur kontrolli në përfundimin se faturat e blera janë fiktive, pasi që disa nga këto fatura tatimore janë realizuar para datës së anulimit të certifikatës së TVSH-së dhe publikimit në evidencat e tatimpaguesve jo-aktiv. Nga Raporti i Kontrollit dt.12.07.2013 me rastin e intervistës fillestare me përfaqësuesin e paditësit, nuk janë dhënë informata se paditësi është ballafaquar me faturat blerëse, nuk është sqaruar fakti se a është pranuar malli sipas këtyre faturave nga paditësi, nuk është cekur se në çfar mënyre është bërë transaksioni i pagesës së këtyre faturave apo është bërë ndonjë kompensim i materialit të faturave me ndonjë shërbim tjetër siq pretendon paditësi në seancën gjyqësore.

Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, e paditura Departamenti i Shërbimeve Juridike i ATK-së me parashitesën e dt.22.11.2016 me të cilën kundërshton ekspertizën financiare plotsuese dt.14.11.2016, vlersimet e veta se faturat janë fiktive e mbështet në atë se me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PPRKR nr.122/13 dt.07.06.2013 është konfirmuar se disa prej këtyre subjektëve që kanë lëshuar fatura, ka filluar procedura penale për përfitim të paligjshëm dhe shmangie tatimore.

Në anën tjetër gjykata për të harmonizuar veprimet dhe vendimet e veta dhe për tu aplikuar një praktik unike gjyqësore, në rastin konkret ka marr për bazë edhe aktgjykimin ARJ-UZVP nr.39/2015 dt.27.04.2016 i nxjerr nga Gjykata Supreme e Kosovës, i cili vendim referohet në faturat të ngjashme por nga subjekt tjer tatimor. Në rastet e tilla kjo gjykat ka shtruar dilemat se faturat kontestuese të lëshuara nga subjektët në fjalë, a janë vërtetuar në ndonjë procedurë të parashikuar ligjore qoftë penale apo civile, të cilat do ta kenë cilësin e provës në procedurën administrative, pastaj theksohet edhe rekomandimi i Grupit profesional i ATK-së dt.04.08.2010 lidhur me transaksionet e publikuara para 9 shtatorit 2009.

Gjykata duke u referuar në këto rekomandime të Gjykatave më të larta, nga provat e lëndës që i ka dorzuar e paditura, ka vërtetuar se me Aktvendimin PPRKR nr.122/13 dt.07.06.2013 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, janë ndërmarr masa ligjore të përkohshme kundër disa personave fizik (të pandehur), sipas KPK, dhe kjo gjykatë në konfliktin administrativ nuk posedon asnjë provë tjetër që dëshmon se në procedurën penale gjykata ka vërtetuar fajësin e këtyre personave të cilët dyshohen se janë përgjegjës për kryerje të veprës penale që lidhen edhe me faturat kontestuese.

Meqë gjykata nuk posedon prova tjera konkrete nga pala e paditur se në procedurën penale është marrë një vendim i formës së prerë nga gjykata penale, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike gjatë procedurës së kontrollit, kjo gjykat me qëllim të konstatimit të drejt të çështjes, me prova materiale shtesë, i duhet sqarim plotsues, verifikim dhe sigurim i provave shtesë, në mënyrë që konstatimi i dhënë në arsyetim të aktvendimit të kontestuar lidhur me faturat kontestuese. Gjykata kërkon nga e paditura që në rivendosje gjatë procedimit administrativ të verifikoj se a është vendosur në procedurën penale kjo çështje, dhe obligohet të zbatoj vendimin e formës së prerë të gjykatës penale, e në rast se ende nuk ekziston një vendim i tillë dhe procesi është në fazën e hetimeve, atëher sa i përket këtyre faturave kontestuese blerëse vitit 2009, 2010, të bëj pezullimin e vlerësimit të këtyre faturave konform nenit 17 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, deri në plotfuqishmërin e aktgjykimit penal. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura ta mbështes vendimin në provat konkrete materiale dhe në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, ashtu që paraprakisht të ndërmarr edhe informatat e nevojshme nga paditësi lidhur me mënyrën e realizimit të transaksioneve sipas faturave blerëse, dhe të vlersoj se fatura e datës 26.03.2009 nga subjekti V. Oil, a është fatur e rregullt sipas Rekomandimit të Grupit profesional i ATK-së dt.04.08.2010 lidhur me transaksionet e publikuara para 9 shtatorit 2009.

Në bazë të rekomandimeve nga Gjykata Supreme dhe e Apelit, gjendjes faktike, ballafaqimit dhe ekzaminimit të provave në procedurën e rivendosjes të konfliktit administrativ gjyqësor, kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e paditësit janë të bazuara vetëm lidhur me blerjet e mjeteve themelore për periudhën 2009,2010 dhe për këtë periudhë vlersimi, gjykata e detyron të padituren Departamenti i Ankesave i ATK-së që në rivendosje të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi dhe pasi ti mënjanoj ato, të marr vendim të drejt dhe të ligjshëm. Vlersimet tjera mbesin në fuqi sipas vendimit nr.253/2013 dt.18.10.2013 i Departamentit të Ankesave i ATK-së, me të cilin është aprovuar pjesërisht ankesa e paditësit.

Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 dhe nenit 43 par.2 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal  
A.nr.1008/2016 datë 13.12.2016

Gjyqtari,  
Krenar Berisha

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.